



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 173

Tiranë – E hënë, 5 tetor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gkykatës Kushtetuese nr. 60, datë 21.9.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1223, datë 22.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe nr. 00-2014-3533, datë 09.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	11887
Vendim i Gkykatës Kushtetuese nr. 61, datë 23.9.2015	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.....	11890
Vendim i Gkykatës Kushtetuese nr. 62, datë 23.9.2015	Me objekt shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1506, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 135, datë 19.04.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2013-782, datë 19.04.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	11896
Vendim i Gkykatës Kushtetuese nr. 63, datë 23.9.2015	Me objekt: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr. 45, datë 2.12.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr. 175, datë 16.07.2014 të Gjykatës së Lartë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.....	11902
Vendim i Gkykatës Kushtetuese nr. 64, datë 23.9.2015	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.....	11906



VENDIM
Nr. 60, datë 21.9.2015
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 09.06.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Vasil (Sadedin) Xhaferi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Krenar Rugji, Telo Rushiti, Partizan Ballaci, Martin Kendezi, Agim Halili, Beqir Tershalla, Qerim Dervishi, Koço Jano, Jasim Cuni, Bilbil Halili, Vangjel Xhaferi, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1223, datë 22.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe nr. 00-2014-3533, datë 09.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 29.04.2005 kërkuari Vasil (Sadedin) Xhaferi ka lidhur një aktmarrëveshje

nr. 592 kol., nr. 2680 rep. me subjektet e interesuara, Krenar Rugji dhe Telo Rushiti, sipas së cilës në këmbim të një detyrimi prej 1 milion lekësh do të përfitonte një sipërfaqe trualli prej 75 m², si dhe një sipërfaqe lokali prej 24 m² që do të dilte nga ndërtimi.

2. Subjektet e interesuara Krenar Rugji dhe Telo Rushiti i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesëpadi me objekt, ndër të tjera, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të deklaratës noteriale (aktmarrëveshje) nr. 2680 repertori, datë 29.04.2005 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Me vendimin nr. 1223, datë 22.12.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndër të tjera, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të deklaratës noteriale nr. 592 kol., nr. 2680 rep. të datës 29.04.2005, të lidhur me kërkuarin, si dhe zgjidhjen e pasojave, detyrimin e subjekteve të interesuara t'i paguajnë kërkuarit të gjitha shpenzimet e bëra dhe të përcaktuara në deklaratë. Ky proces është zhvilluar në mungesë të kërkuarit.

3. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim subjektet e interesuara, Krenar Rugji dhe Telo Rushiti, dhe Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 162, datë 25.04.2007, ndër të tjera, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë si më poshtë: konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktmarrëveshjes nr. 592 kol., nr. 2680 rep. të datës 29.04.2005 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Edhe ky proces është zhvilluar në mungesë të kërkuarit.

4. Kërkuari ka pretenduar se nuk i është komunikuar vendimi nr. 162, datë 25.04.2007 i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe se dëftesa e komunikimit nr. 207 akti e datës 21.05.2007 për njoftimin e këtij vendimi nuk është firmosur prej tij. Në këto rrethana ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila, me vendimin nr. 23-2011-1642 (990), datë 05.09.2011, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së dëftesës së komunikimit së lartpërmendur, duke e rivendosur kërkuarin në afat për të ushtruar të drejtën e rekursit kundër vendimit nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër.

5. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 502, datë 22.11.2011, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.



6. Pas rivendosjes në afat, kërkuesi ka ushtruar të drejtën e rekursit ndaj vendimit nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2014-3533, datë 09.12.2014 ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi me pretendimin se këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:

7.1 Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar në gjykatë. Mosnjoftimi efektiv mbi procesin gjyqësor i ka cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit. Padijenja për zhvillimin e proceseve gjyqësore ka qenë rrjedhojë e mosnjoftimit të kërkuesit, e vërtetuar kjo edhe nga vendimet gjyqësore që kanë deklaruar të pavlefshme dëftesën e komunikimit, si dhe nga fakti se gjatë kësaj periudhe kohe kërkuesi ka qenë jashtë Shqipërisë.

7.2 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa paraqitur arsytet për këtë qëndrim. Gjykata e Lartë ishte në dijeni të të dyja vendimeve që kishin vendosur pavlefshmërinë e dëftesës së komunikimit, e cila vërtetonte se kërkuesi nuk kishte pasur dijeni për proceset e zhvilluara ndaj tij, arsye për të cilën çështja duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të marrë pjesë në gjykim

8. Kërkuesi pretendon se ai nuk ka qenë në dijeni të proceseve gjyqësore të zhvilluara për shkak të mosnjoftimit të tij. Si pasojë e mospjesëmarrjes së kërkuesit në gjykim, atij i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, si dhe e drejta e mbrojtjes e lidhur me respektimin e parimeve të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

9. Gjykata në jurisprudencën e saj konstante ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Pra, e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 31, datë 26.05.2014; nr. 18, datë 23.04.2013; nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë aspekt „në jurisprudencën kushtetuese e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, përkundrazi duhet që gjykata gjatë gjykimit t'u japë mundësi të barabarta palëve, në përputhje me legjislacionin procedural, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Edhe parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i së drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 31, datë 26.05.2014; nr. 18, datë 23.04.2013; nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga ana tjetër, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131/f të



Kushtetutës individi mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 28, datë 23.06.2011; nr. 27, datë 20.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 28, datë 23.06.2011; nr. 15, datë 18.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 28, datë 23.06.2011; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin objekt shqyrtimi Gjykata vëren se nga vendimi nr. 1223, datë 22.12.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë rezulton se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin gjyqësor dhe pa shkak ligjor nuk është paraqitur në gjykim. Edhe nga vendimi nr. 162, datë 25.04.2007 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër rezulton se gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Gjithashtu, Gjykata vëren se gjatë procesit gjyqësor të rivendosjes në afat kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me mospasjen dijeni të procesit gjyqësor. I vetmi pretendim i kërkuesit ka qenë se dëftesa e komunikimit të vendimit nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër është e falsifikuar. Ky fakt vërtetohet nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr. 23-2011-1642 (990), datë 05.09.2011, i lënë në fuqi nga vendimi nr. 502, datë 22.11.2011 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Nga këto dy vendime rezulton se dëftesa e komunikimit nr. 207 akti, e datës 21.05.2007 të vendimit nr. 162, datë 25.04.2007 nuk është firmosur prej kërkuesit. Për këtë arsye kërkuesi është rivendosur në afat për të ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

13. Gjykata, gjithashtu, konstaton se në rekursin e ushtruar nga kërkuesi, ky i fundit nuk ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar

nga gjykata, por ka ngritur disa pretendime të tjera, të cilat lidhen me pabazueshmërinë në fakte dhe në ligj të vendimeve të gjykatave dhe zhvillimin e gjykimeve pa praninë e bashkëpronarëve të tjerë.

14. Për pasojë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim jo vetëm nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për t'iu drejtuar kësaj Gjykate, por nuk ka paraqitur asnjë argument për të mbështetur këtë pretendim. E vetmja e drejtë e cenuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mosnjoftimi i vendimit nr. 162, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, është korrigjuar nëpërmjet rivendosjes në afat. Prandaj Gjykata çmon se pretendim i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim është haptazi i pabazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

15. Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi ka vendosur mospranimin e rekursit pa argumentuar arsyet e këtij qëndrimi. Sipas kërkuesit, edhe pse Gjykata e Lartë ishte në dijeni të të dyja vendimeve që kanë vendosur pavlefshmërinë e dëftesës së komunikimit, ajo nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, bazuar në nenin 480 të KPC-së, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivist nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e saj të vendosë mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Po në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.07.2005; nr. 22, datë 06.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



17. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata në rastin në shqyrtim nuk konstaton cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ky i fundit, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs i ka dhënë përgjigje kërkuesit se ato nuk përmbushin kushtet e nenit 472 të KPC-së.

18. Edhe për sa i përket arsyetimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, Gjykata ka vlerësuar tashmë se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve (*shih vendimet nr. 36, datë 26.07.2011; nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 6, datë 10.02.2014; nr. 17, datë 24.03.2014; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kushtet kur nuk ka pretendime të natyrës kushtetuese, ky arsyetim i vendimeve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se procesi i zhvilluar ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.

19. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe, për pasojë, kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM Nr. 61, datë 23.9.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 05.05.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Petrit Ponari, përfaqësuar nga avokat Besim Peka, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Shëndetësisë Shoqëria Përmbarrimore “Tirana Bailiff’s Service” sh.p.k.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Shëndetësisë, shpjegimet e subjektit të interesuar, shoqërisë përmbarrimore “Tirana Bailiff’s Service” sh.p.k., dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë në detyrën e drejtorit të Personelit dhe Burimeve Njerëzore, detyrë të cilën e ka



kryer deri në daljen e aktit administrativ nr. 4063 prot, datë 13.09.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm, me anë të të cilit i është dhënë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil.

2. Kërkuesi e ka kundërshtuar në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC) aktin administrativ të lartpërmendur, i cili nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën e tij brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

3. Në këto kushte kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e aktit nr. 4063 prot, datë 13.09.2013, kthimin në detyrë të tij dhe akordimin e pagës deri në momentin e rikthimit në detyrë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 142, datë 26.12.2013 ka vendosur: pranimin e kërkesëpadisë; shfuqizimin e aktit nr. 4063 prot, datë 13.09.2013; detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Shëndetësisë, të kthejë kërkuesin në detyrën e drejtorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të Edukimit dhe në pamundësi në një pozicion ekuivalent; detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Shëndetësisë, t'i paguajë pagën kërkuesit nga momenti i lirimit deri në rikthimin e tij.

5. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 173, datë 12.02.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.02.2014.

6. Pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ka marrë formë të prerë, kërkuesi, bazuar në nenin 65/1 të ligjit nr. 49/2012, në datën 29.05.2014 i është drejtuar shoqërisë përmbarimore “Tirana Bailiff’s Service” sh.p.k. për ekzekutimin e vendimeve të lartpërmendura.

7. Shoqëria përmbarimore, me shkresën nr. 291 prot, datë 25.09.2014, në respektim të ligjit, ka njoftuar debitorin, Ministrinë e Shëndetësisë, për ekzekutim vullnetar të vendimit të formës së prerë.

8. Ministria e Shëndetësisë nuk e ka ekzekutuar vullnetarisht vendimin gjyqësor, prandaj me shkresën nr. 342 prot, datë 09.06.2014 shoqëria përmbarimore i është drejtuar debitorit me vendim për kalim në ekzekutim të detyruar.

9. Shoqëria përmbarimore ka vijuar me këto shkresa ndaj debitorit, Ministrisë së Shëndetësisë:

shkresë nr. 358 prot, datë 16.06.2014 “Kërkesë për ekzekutim të vendimit gjyqësor”; shkresë nr. 386 prot, datë 26.06.2014 dhe nr. 392, datë 02.07.2014 “Kërkesë e përsëritur për ekzekutim të vendimit gjyqësor”.

10. Duke qenë se asnjë nga shkresat e lartpërmendura nuk ka marrë përgjigje, me shkresën nr. 411, datë 10.07.2014 me objekt “Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative”, shoqëria përmbarimore ka urdhëruar Degën e Thesarit të vendosë sekuestron konservative në llogarinë e debitorit.

11. Gjithashtu, me shkresë nr. 473, datë 05.09.2014 shoqëria përmbarimore ka vendosur gjobitjen e zotit Alfred Careri, në cilësinë e sekretarit të Përgjithshëm pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në shumën 50.000 lekë për mospërbushjen e detyrimeve ligjore, duke u bërë pengesë për zbatimin e titullit ekzekutiv.

12. Përsëri me shkresën nr. 555 prot, datë 13.11.2014 dhe me shkresën nr. 639 prot, datë 14.01.2015 nga ana e shoqërisë përmbarimore i është kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë ekzekutimi i vendimit gjyqësor.

13. Në datën 27.11.2014 Ministria e Shëndetësisë ka transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë përmbarimore shumën prej 389.549 lekësh në favor të kërkuesit.

14. Ndërsa në datën 15.01.2015 Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar shoqërinë përmbarimore se i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike për marrjen e masave për sistemimin në punë të kreditorit.

15. Pavarësisht kërkesave të përsëritura, kërkuesi dhe shoqëria përmbarimore kanë hasur në pasivitetin e autoriteteve të ngarkuara nga ligji për zbatimin e plotë të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

II

16. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

17. **Subjekti i interesuar**, Ministria e Shëndetësisë, ka prapësuar me shkrim se:



17.1. Lidhur me detyrimin për rikthimin e kreditorit në vendin e punës, në strukturën e Ministrisë, aprovuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 187, datë 18.10.2013, si dhe më vonë me urdhrin nr. 21, datë 20.02.2015, nuk ekziston pozicioni i Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe të Edukimit në Vazhdim, detyrë që kryhej nga kërkuesi përpara lirimit nga shërbimi civil. Ndërkohë, Ministria, me shkresën nr. P-67/1 prot, datë 29.12.2014, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike për të gjetur mundësinë e sistemimit të kërkuesit në një pozicion analog, në zbatim të vendimit të formës së prerë.

17.2. Lidhur me detyrimin për pagesën e pagës, ministri i Shëndetësisë, me shkresën nr. prot. 3930/12, datë 09.09.2014, ka lëshuar autorizimin nr. 376, datë 09.09.2014, me anë të të cilit autorizon përmbushjen e detyrimit financiar në favor të kërkuesit dhe ngarkon sektorin e Financës për ekzekutimin për këtë pjesë të vendimit nr. 142, datë 26.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sektori i Financës ka filluar dhe vazhdon me likuidimin e detyrimit financiar që Ministria e Shëndetësisë ka ndaj kërkuesit.

18. Subjekti i interesuar, shoqëria përmbarimore “Tirana Bailiff’s Service” sh.p.k., ka parashtruar me shkrim se ka kryer të gjitha veprimet procedurale të parashikuara nga ligji në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosëkzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

19. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është konsideruar në jurisprudencën e Gjykatës si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet*

nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 23, datë 17.05.2010, nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.

21. Gjykata, gjithashtu, në jurisprudencën e saj ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit (*shih vendimet nr. 9, datë 14.02.2014; nr. 21, datë 03.06.201; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosëkzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e secilit prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

23. Në lidhje me periudhën që duhet të merret në konsideratë, Gjykata vëren se procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm janë vënë në lëvizje nga kërkuesi me vendimin 173, datë 12.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili



ka marrë formë të prerë në të njëjtën datë, në datën 12.02.2014. Ndërsa procedurat përmba-
rimore kanë filluar në datë 29.05.2014 me
lajmërimin e debitorit për ekzekutim vullnetar.
Në këto kushte, periudha që duhet marrë në
konsideratë është nga momenti që vendimi
gjyqësor ka marrë formë të prerë deri në datën
19.02.2015, kur kërkuesi i është drejtuar kësaj
Gjykate.

ii. Kompleksiteti i çështjes

24. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e
kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë
rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi
objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe
volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i
çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të
administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund
të justifikojë kohëzgjatje kohore të
konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë
15.04.2010; nr. 9, datë 14.02.2014 të Gjykatës
Kushtetuese*).

25. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka
për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës
së prerë brenda një afati të arsyeshëm për sa i
përket rikthimit në vendin e punës të kreditorit
dhe likuidimit të pagës deri në momentin e
rikthimit në detyrë. Nga shqyrtimi i dokumenteve
të paraqitura Gjykata vlerëson se çështja
konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo
komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në
ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së
autoriteteve publike dhe kërkuesit është me
rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuesit

26. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të
kërkuesit është një element tjetër përcaktues i
kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve.
Gjykata ka theksuar se përdorimi nga ana e
kërkuesit i të gjitha procedurave të parashikuara
nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e
mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument
kundër tij (*shih vendimet nr. 1, datë 19.01.2009; nr.
9, datë 01.04.2009; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 14,
datë 15.04.2010; nr. 24, datë 22.04.2014 të Gjykatës
Kushtetuese*).

27. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton
se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat
procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në
dispozicion të tij për ekzekutimin e detyrimit që
buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ai

ka shfaqur interes të vazhdueshëm për
ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak
apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv. Sjellja e autoriteteve

28. Gjykata ka theksuar se në fazën e
ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra
debitori dhe kreditori, por edhe organet
kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e
vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i
këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori
nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin
e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i
vendosjes në vend i një të drejte të shkelur
përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave,
por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve
konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me
ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së
prerë (*shih vendimet nr. 6, datë 04.03.2010; nr. 24,
datë 22.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në çështjen në shqyrtim rezulton se
përmbauesi gjyqësor, në cilësinë e subjektit
procedural në fushën e ekzekutimit, ka kryer të
gjitha veprimet procedurale për ekzekutimin e
vendimit gjyqësor. Ai jo vetëm i është drejtuar
debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit,
por edhe ka urdhëruar Degën e Thesarit të
vendosë sekuestron konservative në llogarinë e
debitorit, Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe ka
vendosur masën me gjobë ndaj eprorit të
institucionit debitor. Për pasojë, Gjykata vlerëson
se ky subjekt jo vetëm që nuk është bërë shkak
për mosekzekutimin e vendimit të formës së
prerë, por ka vepruar në përputhjet me
kompetencat e tij ligjore.

30. Në lidhje me sjelljen e debitorit, Gjykata
ka theksuar se i takon këtij të fundit të gjejë një
mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me
qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit.
Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen
me pamundësinë për të mos respektuar një
detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por
duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe
mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar
atë (*shih vendimet nr. 2, datë 01.02.2011; nr. 10, datë
01.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa për sa i
përket detyrimit për pagesën e pagës për
periudhën e qëndrimit pa punë, Gjykata ka
theksuar se argumentet lidhur me mungesën e
fondeve janë të pamjaftueshme dhe nuk
justifikojnë mospagimin e detyrimit. Kërkuesit



nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfitur nga rezultati i favorshëm i procesit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit dhe se një vonesë në ekzekutim mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate (*shih vendimet nr. 48, datë 26.07.2012; nr. 17, datë 23.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Ministria e Shëndetësisë në komentet me shkrim të depozituara ka prapësuar se në momentin e dhënies së vendimit nr. 173, datë 12.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në organikën e këtij institucioni, sipas urdhrin të Kryeministrit nr. 187, datë 18.10.2013 si dhe më vonë me urdhrin nr. 21, datë 20.02.2015, nuk ekziston pozicioni i drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe të Edukimit në Vazhdim, detyrë që kryhej nga kërkuesi përpara lirimit nga shërbimi civil. Për këtë qëllim, Ministria e Shëndetësisë, me shkresën nr. P-67/1 prot., datë 29.12.2014 i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP) për të gjetur mundësinë e sistemimit në punë të kërkuesit, në zbatim të vendimit të formës së prerë.

32. Në vlerësimin e Gjykatës rrethana se në organikën e institucionit debitor nuk ekziston më pozicioni që mbante kërkuesi përpara lirimit nga shërbimi civil nuk justifikon mospërmbushjen e detyrimit që rrjedh nga vendimi i formës së prerë nga ana e debitorit. Ky i fundit duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për rikthimin në punë të kërkuesit, qoftë edhe në një pozicion ekuivalent, sipas dispozitivit të vendimit nr. 142, datë 26.12.2013 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si një detyrim ligjor i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Ndërkohë mospërmbushja e këtij detyrimi brenda një afati të arsyeshëm sjell për pasojë rritjen në mënyrë progresive të detyrimit financiar, çka rrjedhimisht rëndon në buxhetin e shtetit.

33. Gjykata, gjithashtu, konstaton se detyrimi për rikthimin e kërkuesit në detyrën e drejtorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të Edukimit dhe në pamundësi, në një pozicion ekuivalent është në ngarkim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Shëndetësisë, e cila,

sikurse u theksua më lart, nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për planifikimin në punë të tij. Ndërsa shkresa që Ministria e Shëndetësisë i ka dërguar DAP-it, me anë të së cilës e ka vënë atë në dijeni mbi praktikën e kërkuesit, është formale dhe nuk shkarkon nga përgjegjësia Ministrinë e Shëndetësisë për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

34. Lidhur me likuidimin e pagës, nga materialet e depozituara Gjykata vëren se ministri i Shëndetësisë, me shkresën nr. prot. 3930/12, datë 09.09.2014, ka lëshuar autorizimin nr. 376, datë 09.09.2014, me anë të të cilit autorizon likuidimin e kërkuesit dhe ngarkon sektorin e Financës për ekzekutimin e detyrimit që rrjedh nga vendimi nr. 142, datë 26.12.2013 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, në datën 27.11.2014 Ministria e Shëndetësisë ka transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë përmbartimore shumë prej 389.549 lekësh në favor të kërkuesit.

35. Referuar pretendimeve të kërkuesit Gjykata konstaton se edhe pse në kërkesën fillestare ai ka pretenduar se detyrimi monetar nuk është ekzekutuar nga ana e debitorit, në komentet me shkrim dërguar më pas Gjykatës, kërkesa përqendrohet vetëm në rikthimin në punë të tij. Duke konsideruar edhe faktin se debitori ka shfaqur vullnet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor lidhur me likuidimin e pagës dhe ka shlyer një pjesë të detyrimeve për këtë pjesë, Gjykata vlerëson se nuk konstatohet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor në lidhje me këtë detyrim.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji është i bazuar vetëm për pjesën e detyrimit të rikthimit në punë të kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 142, datë 26.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 172, datë 12.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, vetëm për rikthimin në punë të kërkuarit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Petrit Ponarin dhe me objekt *konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*, nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës.

2. Shumica ka vlerësuar se pretendimi i kërkuarit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, është i bazuar vetëm për pjesën e detyrimit të rikthimit në punë të kërkuarit (§ 36 i vendimit).

3. Ashtu siç është evidentuar edhe nga shumica, Gjykata i analizon pretendimet për kohëzgjatje të arsyeshme të procedimeve nën dritën e rrethanave të çështjes duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit (§ 21 i vendimit).

4. Sipas shumicës, çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për sa i përket rikthimit në vendin e punës të kërkuarit dhe likuidimit të pagës deri në momentin e rikthimit në detyrë. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura shumica ka vlerësuar se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në

ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst (§ 25 i vendimit).

5. Lidhur me vlerësimin e kompleksitetit të rrethanave të çështjes konkrete shumica duhej të ishte ndalur në kuadrin ligjor përkatës. Kështu, ligji nr. 152, datë 30.05.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, në nenin 7, shkronja ”dh” përcakton se Departamenti i Administratës Publike ndërmjet të tjerash ka edhe detyrën e përgatitjes së planit vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore. Ndërsa Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” përcakton: “Institucionet e administratës shtetërore/institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, për planifikimin vjetor të pranimit në shërbimin civil, të kenë parasysh: a) mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil; b) parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil; c) ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike (pika 3)”. Më tej parashikohet se “çdo institucion i administratës shtetërore përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm. [...] Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Kryeministri dhe çdo ministri hartojnë planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatit e tij dhe institucionet e varësisë. [...] Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo ministrive, brenda muajit nëntor, i dërgon Departamentit të Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për pranim për të gjithë sistemin përkatës. [...] Departamenti i Administratës Publike, deri në fund të muajit dhjetor, harton projektvendimin për planifikimin vjetor të pranimit për administratën shtetërore. [...] Projektvendimi i përgatitur sipas pikës 8 të këtij vendimi propozohet në Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës për administratën publike deri në fund të muajit janar. [...] Këshilli i Ministrave, jo më vonë se fundi i muajit shkurt, miraton planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore (pikat 4, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave).

6. Në këndvështrim të këtij kuadri ligjor rregullator rezulton se ka një proces dhe procedurë të caktuar mbi të cilën veprojnë dhe



ndërveprojnë disa institucione përgjegjëse secila për detyra specifike për të hartuar dhe miratuar planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për çdo vit. Në këto kushte, nuk mund të thuhet se çështja nuk ka kompleksitet për shkak të mënyrës se si veprohet në të tilla raste, ku bashkëveprimi, bashkëpunimi dhe zbatimi me përpikëri në kohë dhe cilësi i të gjitha detyrave të ngarkuara institucioneve përkatëse janë thelbësore për respektimin e planit vjetor të pranimit.

7. Duke iu kthyer rastit konkret konstatohet se procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm janë vënë në lëvizje nga kërkuesi me vendimin nr. 173, datë 12.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë në të njëjtën datë, në datën 12.02.2014. Kërkuesi i është drejtuar kësaj Gjykate në datën 19.02.2015. Ministria e Shëndetësisë, me shkresën nr. P-67/1 prot., datë 29.12.2014 i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP) për të gjetur mundësinë e sistemimit në punë të kërkuesit, në zbatim të vendimit të formës së prerë.

8. Nisur nga këto fakte, periudha rreth 1 vit (12.02.2014 -19.02.2015), e cila është marrë në analizë nga Gjykata për efekt të rikthimit në punë të kërkuesit, nuk është një afat i tillë për të dalë në konkluzionin se ka pasur shkelje në drejtim të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një kohëzgjatje të arsyeshme. Kjo për shkak se duke iu referuar Planit Vjetor të Pranimit për vitin 2015, mbi bazën e të cilit duhet të ekzekutohet edhe vendimi nr. 173, datë 12.02.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, rezulton se procesi për kthimin në punë të kërkuesit është një proces në vazhdimësi. Ky proces për krijimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil nuk është përmbyllur dhe nuk i ka ezauruar ende efektet.

9. Për sa më sipër, vlerësoj se, bazuar në rrethanat e çështjes, periudhën kohore për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, sjelljen e autoriteteve dhe kompleksitetin e çështjes, pretendimi i kërkuesit për cenimin e procesit të rregullt, për shkak të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, është i pabazuar dhe, rrjedhimisht, shumica duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM Nr. 62, datë 23.9.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 07.07.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 37 Akti, që u përket:

KËRKUES: Viktor Thomo¹

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kristaq Thomo, Salih Tagani

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1506, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 135, datë 19.04.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2013-782, datë 19.04.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 18, 42/1, 131/f, 134/1/g, 134/2 dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 24, 27, 28, 30 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar Kristaq Thomo, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të

¹ Sipas vendimeve gjyqësore të kundërshtuara mbiemri i kërkuesit rezulton “Thomo”, kurse sipas kartës së identitetit bashkëlidhur kërkesës rezulton “Thoma”.



subjektit të interesuar Salih Tagani, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 1960 shtetasi TH.TH. (babai i kërkuarit) ka blerë një shtëpi nga Komiteti Ekzekutiv i Qytetit të Tiranës nëpërmjet një kontrate shitblerjeje (e regjistruar rregullisht në regjistrat hipotekorë të këtij viti), të cilën në vitin 1982 ia ka dhuruar bashkëshortes së tij. Pas vdekjes së kësaj shtetase kjo pasuri ka kaluar në pronësi të fëmijëve të saj, shtetasve Viktor Thomo (kërkuar) dhe Kristaq Thomo.

2. Me vendimin nr. 82, datë 26.06.1995 të KKKP-së Tiranë, trashëgimtarëve të ish-pronarit SH.P. u është njohur dhe kthyer një pasuri e paluajtshme, e përbërë nga një sipërfaqe truall dhe dy shtëpitë mbi të, vendim që është regjistruar edhe në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë. Njëra prej dy shtëpive rezulton të jetë ajo e blerë nga babai i kërkuarit.

3. Në cilësinë e bashkëpronarit mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor, subjekti i interesuar Salih Tagani i është drejtuar gjykatës me padi rivendikimi të sendit, bazuar në nenin 296 të Kodit Civil (KC), për lirimin dhe dorëzimin e shtëpisë në bashkëpronësi të kërkuarit dhe vëllait të tij.

4. Me vendimin nr. 5136, datë 02.07.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1553, datë 01.10.2008, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim.

5. Me vendimin nr. 576, datë 15.12.2011, Gjykata e Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1553, datë 01.10.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjyqësor”*.

6. Me vendimin nr. 1506, datë 13.06.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 5136, datë 02.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: Pranimin e kërkesëpadsisë. Detyrimin e të paditurve Viktor Thomo dhe Kristaq Thomo t'i lirojnë dhe dorëzojnë paditësit Salih Tagani trullin prej 350m² dhe shtëpinë e ndërtuar mbi të, të përbërë nga 4 dhoma, kuzhinë, me vendndodhje dhe kufizime të përcaktuara në titullin e pronësisë dhe aktin e ekspertimit*

të datës 08.06.2012, që i bashkëngjitet vendimit...”. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur në Gjykatën e Lartë si rekurs, ashtu edhe kërkesë për pezullim.

7. Me vendimin nr. 135, datë 19.04.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për pezullim.

8. Me vendimin nr. 00-2013-782, datë 19.04.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

9. **Kërkuar Viktor Thomo** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

9.1 Gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, duke prekur titullin e pronësisë së familjes Thomo, të fituar në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tij. Ato kanë cenuar edhe parimin e së drejtës të fituar, i cili nënkupton pamundësinë për të vënë në diskutim një të drejtë të fituar ligjërisht duke u bazuar në një ligj të ri.

9.2 Gjykata e Apelit e pranoi faktin se kërkuar ka fituar pronën në një nga format që pranon dhe njeh ligji, por ajo nuk ka zhvilluar një gjykim për ta deklaruar të pavlefshme kontratën e vitit 1960, me anë të së cilës është fituar pronësia. Gjykata nuk ka pasur parasysh as institutin e parashkrimit fitues, i parashikuar në nenin 168 të KC-së.

9.3 Gjykata e Apelit nuk mori parasysh as provat e paraqitura nga kërkuar, as ato të dërguara nga ZVRPP-ja Tiranë, me kërkesë të vetë gjykatës, nuk i analizoi dhe nuk u shpreh për to në vendim.

9.4 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, i ka cenuar kërkuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Edhe pse ndodhej përpara dy vendimeve diametralisht të kundërta, si edhe për shkak të natyrës së të drejtës së pretenduar, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, duke cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të arsytimit të vendimit të saj.

9.5 Në të njëjtën datë janë shqyrtuar në të njëjtën dhomë këshillimi (me pjesëmarrjen e katër gjyqtarëve të njëjtë) si rekursi, ashtu edhe kërkesa për pezullim.



10. **Subjekti i interesuar Kristaq Thomo** në parashtrimet drejtuar Gjykatës ka kërkuar pranimin e kërkesës, duke argumentuar sa vijon:

10.1 Vendimet e kundërshtuara kanë cenuar parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme. Familja Thomo ka poseduar në mënyrë të ligjshme për rreth 46 vjet pronën në fjalë, që nga momenti i blerjes së saj (1960) deri në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë (2006). Por edhe nëse llogaritet momenti i daljes së vendimit të KKKP-së (1995) ata sërish e kanë poseduar qetësisht për rreth 11 vjet. Në këto kushte, në bazë të nenit 168 të KC-së, ata janë pronarë të ligjshëm.

10.2 Vendimi i Gjykatës së Apelit, edhe pse pranon se shtetasit Viktor dhe Kristaq Thomo deri në momentin e daljes së vendimit të KKKP-së kanë qenë posedues dhe pronarë të ligjshëm të pronës dhe nuk kanë pasur dijeni për këtë vendim, ka njohur si pronar subjektin e interesuar.

10.3 Edhe pse këto pretendime janë ngritur në rekurs, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka argumentuar mbi ato, ndaj ky vendim nuk plotëson as standardet minimale të arsytimit të vendimit. Në kushtet kur dy gjykata të niveleve të ndryshme i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së konfliktit mbi të drejtën e pronësisë, Kolegji Civil duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. Duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese është cenuar jo vetëm e drejta e aksesit, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial.

11. **Subjekti i interesuar Salih Tagani** në parashtrimet drejtuar Gjykatës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar sa vijon:

11.1 Kërkesa nuk plotëson kushtet e nenit 131 të Kushtetutës, pasi nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk rezulton që kërkuarit t'i jetë cenuar ndonjë e drejtë e ligjshme. Në vitin 1960 shtëpia i është shitur babait të kërkuarit, i cili ia ka dhuruar bashkëshortes në vitin 1994 dhe kjo pasuri është regjistruar në emër të saj në vitin 1996, pra pas 15 muajsh nga koha kur kjo pasuri u është kthyer pronarëve të ligjshëm dhe është regjistruar në emër të tyre. Kërkuari nuk është pronar i sendit, pasi në momentin e vdekjes së nënës së tij ky send nuk ka qenë në pronësi të saj, sepse të drejtat e pronësisë mbi këtë banesë iu janë rivendikuar trashëgimtarëve legjitimë. Në momentin e ngritjes

së padisë dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor, statusi i kërkuarit, në përputhje me nenin 304 e vijues të KC-së, është posedues i paligjshëm.

11.2 Në të gjitha procedurat e shqyrtimit të kësaj çështjeje nuk ka asnjë shkelje kushtetuese. Kërkuari nuk paraqet asnjë fakt ku të evidentojë se Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces jo të rregullt. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, Gjykata e Apelit riçeli hetimin gjyqësor, lejoi paraqitjen e provave nga palët, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit, dhe thirri ekspertë në funksion të pretendimeve të ngritura në gjykim, duke respektuar të gjitha të drejtat e njohura nga ligji procedural.

11.3 Në këtë gjykim parimi i sigurisë juridike u cenohet vetëm ish-pronarëve, të cilët që prej vitit 1995 nuk gëzojnë pronën e tyre.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi se i njëjti trup gjykues ka gjykuar edhe rekursin, edhe kërkesën për pezullim, pasi çështjet kanë objekt dhe shkak ligjor të ndryshëm, në kuptim të nenit 72 të KPC-së. Vendimi nr. 135/2013 nuk ka të bëjë me çështje themeli, por me një masë provizore, e cila sipas ligjit procedural merret po nga gjykata që shqyrtonte themelin e çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

12. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, individ mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2013-782, datë 19.04.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individ mund t'i drejtohet Gjykatës për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha



mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuesi ka kërkuar në objekt të kërkesës edhe shfuqizimin e vendimit nr. 135, datë 19.04.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e kërkesës për pezullim, duke paraqitur si argument vetëm faktin se ai është marrë në të njëjtën ditë me vendimin që ka vendosur mospranimin e rekursit dhe se në përbërje të të dy kolegjeve kanë qenë katër gjyqtarë të njëjtë.

16. Gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës vendimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nuk mund të konsiderohet si përfundimtar, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ai nuk vendos në mënyrë përfundimtare mbi themelin e çështjes. Për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për kërkimet që kanë të bëjnë me këtë vendim të Gjykatës së Lartë.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtës së aksesit në gjykatë

17. Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara, pasi, sipas tij, titulli i pronësisë i familjes Thomo është fituar në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni i kohës dhe se kontrata e vitit 1960 për blerjen e pasurisë objekt konflikti gjyqësor nuk është konsideruar e pavlefshme nga gjykatat. Po ashtu, ai pretendon se gjykatat nuk kanë pasur parasysh institutin e parashkrimit fitues, në

kushtet kur ai ishte posedues i ligjshëm në mirëbesim për më shumë se 10 vjet që nga momenti i vendimit të KKKP-së, pasi është vënë në dijeni për të vetëm në momentin e paraqitjes së padisë nga subjekti i interesuar.

18. Konceptin e sigurisë juridike, të të drejtave të fituara, të pritshmërive të ligjshme dhe të besimit të qytetarëve të shteti jurisprudenca kushtetuese i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Gjykata vëren se në gjykimin kushtetues të kërkesave individuale parimi i sigurisë juridike është vlerësuar në harmoni me parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padri kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 27, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimin nr. 27, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga vendimet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi ka qenë palë e paditur në procesin e iniciuar nga subjekti i interesuar, me padi me objekt lirim dhe dorëzimin e sendit të paluajtshëm (shtëpia në pronësi të kërkuesit), në kuptim të nenit 296 të KC-së. Subjekti i interesuar ka pretenduar se legjitimohej në ngritjen e kësaj



padie, në kushtet kur kjo pasuri i është njohur dhe kthyer në cilësinë e trashëgimitarit të ish-pronarit, me vendimin e KKKP-së të vitit 1995. Nga ana tjetër, kërkuesi ka pretenduar para gjykatës se pala e paditur (ai dhe vëllai i tij) janë posedues të ligjshëm, se e kanë fituar pronësinë me anë të një kontrate të rregullt shitjeje, të lidhur me shtetin ish-pronar në vitin 1960, dhe se kanë poseduar qetësisht pasurinë në fjalë deri në momentin e paraqitjes së padisë, duke mos pasur dijeni për vendimin e mësipërm të KKKP-së, që ia kthente këtë pronë ish-pronarit. Pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet e palëve, Gjykata e Shkallës së Parë e ka rrëzuar padinë, kurse Gjykata e Apelit e ka pranuar atë, duke vlerësuar se që prej daljes së vendimit të KKKP-së të vitit 1995, pala e paditur në proces është poseduese e paligjshme, sepse që në këtë moment akti juridik me të cilin është fituar pronësia mbi sendin në fjalë është shfuqizuar.

21. Pavarësisht se pala e paditur në proces ka pretenduar se titulli i pronësisë është i ligjshëm, pasi nuk është kundërshtuar asnjëherë, dhe se e ka poseduar qetësisht dhe në mirëbesim pasurinë në fjalë edhe pas daljes së vendimit të KKKP-së, deri në momentin e ngritjes së padisë, këto pretendime nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit.

22. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të

cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimet nr. 4, datë 05.02.2014; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nga materialet e çështjes konkrete në shqyrtim rezulton se pretendimet e kërkuesit që Gjykata e Apelit nuk ka pasur parasysh titullin e pronësisë së tij, i cili është fituar në mënyrë të ligjshme dhe nuk është deklaruar i pavlefshëm nga gjykatat, si edhe për zbatimin e nenit 168 të KC-së për parashkrimin fitues janë ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, që lidhen me cenimin e të drejtave të fituara, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga



kërkuesi Viktor Thomo, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë asnjë argument për pretendimet e kërkuesit me natyrë kushtetuese, nuk ka respektuar as kërkesat e një vendimi të arsyetuar.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2013-782, datë 19.04.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkues Viktor Thomo, si dhe me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsytimit të saj shumica ka theksuar se nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, që lidhen me cenimin e të drejtave të fituara, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Viktor Thomo, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (§ 25 i vendimit). Ajo ka vlerësuar më tej se vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë asnjë argument për pretendimet e kërkuesit me natyrë kushtetuese, nuk ka respektuar as kërkesat e një vendimi të arsyetuar (§ 26 i vendimit). Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës për arsyet në vijim.

3. Në vlerësimin tim Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në vendimin e saj të marrë në dhomë këshillimi, të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit material dhe vlerësimin e provave. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës



dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 108, datë 03.10.2012; nr. 17, datë 17.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja ka pranuar se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010, § 51*).

4. Siç jam shprehur me mendim pakice në vendimet nr. 4, datë 05.02.2014 dhe nr. 3, datë 23.01.2014, vlerësoj se standardi mbi të cilin mbështetet shumica në këtë çështje nuk krijon garanci për ruajtjen e vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës dhe, për pasojë, lë hapësirë për cenimin e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit. Këtë vlerësim e mbështes në arsyet që vijojnë.

5. Nga arsyetimi i shumicës nënkuptohet se në rastin e ngritjes në rekurs të pretendimeve me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, kur nuk e pranon rekursin, duhet t'u japë përgjigje këtyre pretendimeve. Në një arsyetim a contrario, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në rekurs nuk ngrihen pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t'u japë përgjigje, pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsyetim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsyetimit. Ky lloj diferencimi në trajtimin e arsyetimit, i lidhur me natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, është bërë nga shumica pa parashtruar motivet përse arsyetimi i kufizuar konsiderohet i rregullt në aspektin kushtetues në disa raste dhe i parregullt në raste të tjera.

6. Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht ka identifikuar natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura në të dhe faktin që Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes, duke i imponuar Gjykatës së Lartë argumentimin në lidhje me këto pretendime. Vlerësimi i rekursit

është atribut i Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në rekurs në dhomë këshillimi. Vlerësimi i procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata gjithmonë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

7. Gjithashtu, me qëndrimin e saj shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim pas rigjyqimit në Gjykatën e Lartë. Në rastin konkret shumica i është shmangur vlerësimit kushtetues të pretendimeve që në çmuarjen e saj kanë natyrë kushtetuese, duke e rikthyer çështjen në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, qëndrimi i shumicës nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

8. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmoj se në rastin konkret nuk është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe as e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi duhet të ishte rrëzuar.

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 63, datë 23.9.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 18.06.-2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 28 Akti, që i përket:



KËRKUES: Kristian Begu

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr. 45, datë 2.12.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr. 175, datë 16.07.2014 të Gjykatës së Lartë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 01, datë 16.01.2012, ka deklaruar fajtor kërkuarin për veprën penale “Vrasje me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë dhe e ka dënuar me 20 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda, me vendimin nr. 45, datë 02.12.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 175, datë 16.07.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 45, datë 02.12.2012 të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për kërkuarin.

II

4. **Kërkuari** Kristian Begu i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt

ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se vendimi nr. 01, datë 16.01.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi megjithëse e ka shpallur kërkuarin fajtor, nuk përmban arsyetim në lidhje me fajësinë e tij. Gjithashtu, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë nuk e kanë marrë parasysh pretendimin e cenimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuarit për këtë pretendim. Gjykata e Lartë, duke lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, ka pranuar edhe pjesën arsyetuese të tyre, ku kërkuari nuk është konsideruar si bashkëpunëtor dhe nuk është përcaktuar asnjë rol bashkëpunimi i tij në kryerjen e veprës penale.

5. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar si vijon:

5.1 Si gjykatat e faktit, ashtu edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për vetë kompleksitetin e çështjes, janë munduar maksimalisht që vendimet e tyre të jenë në respektim të nenit 383 të KPP-së, kanë analizuar secilën prej provave të shqyrtuara në gjykim mbi të cilat kanë bazuar vendimet e tyre, si dhe kanë dhënë arsyet ligjore për të cilat i kanë quajtur të papranueshme provat e kundërta.

5.2 Nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të jetë i paarsyetuar, përkundrazi ai plotëson kërkesat e nenit 142/1 të Kushtetutës. Referuar fakteve të paraqitura në vendim kërkuari njihej si pjesëtar i rrethit shoqëror të të gjykuarve dhe duke sugjeruar në vendin e tij kunatin për kryerjen e aksionit kriminal ka dhënë kontribut të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale. Bazuar në këto fakte dhe duke bërë një analizë juridike gjykata e ka deklaruar fajtor kërkuarin për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë.

5.3 Si Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ashtu edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimet e tyre kanë shpjeguar dhe argumentuar arsyet e themelit për dhënien e këtyre vendimeve, duke iu referuar fakteve, provave të administruara, të analizuar në harmoni e njëra-tjetrën, ligjeve të zbatueshme, si dhe kërkesave të palëve, në përmbushje të detyrimit të sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës.



III

vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit

6. Gjykata vlerëson se kërkuar legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, vërehet se kërkuar ka ngritur pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të tria vendimet e gjykatave të zakonshme. Gjykata në vijim ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuarit në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

8. Sipas kërkuarit vendimi nr. 1, datë 16.01.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi megjithëse e ka shpallur kërkuarin fajtor, nuk përmban arsyetimin në lidhje me fajësinë e tij. Gjithashtu, megjithëse kërkuar e ka ngritur këtë pretendim përpara Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykatës së Lartë edhe këto gjykata nuk e kanë marrë parasysh dhe nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuarit për këtë pretendim.

9. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 2, datë 26.01.2015; nr. 3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjyqimit përbëjnë

aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.01.2014; nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 20, datë 13.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit



gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal (KP). Në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë janë paraqitur rrethanat e ngjarjes së datës 05.04.2005, sipas të cilave kërkuesi ka ndihmuar bashkëpunëtorët e tjerë që do të kryenin vrasjen në dëm të shtetasit L.B. (shih fq. 324-338 të vendimit të shkallës së parë). Vendimi nr. 1, datë 16.01.2012 i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që e ka deklaruar kërkuesin fajtor, është kontrolluar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore (fq. 469 e në vijim të vendimit të Gjykatës së Apelit; fq. 388 e në vijim të vendimit të Gjykatës së Lartë).

14. Duke i vlerësuar arsyetimet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë, në këndvështrim të plotësisht të elementeve të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, Gjykata konstaton se vendimet përkatëse përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi penal, analizën e provave të administruara, si dhe vlerësimin e gjykatave në lidhje me fajësinë e kërkuesit dhe caktimin e dënimit. Këto vendime nuk janë alogjike dhe nuk përmbajnë ndonjë kundërthënie të hapur ose të fshehtë. Në aspektin substancial Gjykata vëren se në vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë bërë një arsyetim të detajuar për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të ligjit në lidhje me rrethanat e faktit që i atribuohen kërkuesit. Megjithatë në vlerësimin e Gjykatës kjo nuk përbën një të metë aq serioze sa t'i bëjë të cenueshme vendimet në fjalë në aspektin kushtetues.

15. Për më tepër, kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Gjykata ka theksuar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme, pasi një gjë e tillë do ta kthente atë në një instancë të katërt. Si të tilla, këto çështje i takojnë sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme, që bëjnë vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara dhe jo juridiksionit kushtetues, i cili nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*shih vendimet nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 1, datë 20.01.2012; nr. 23, datë 17.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuadrin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj



VENDIM
Nr. 64, datë 23.9.2015
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	

me sekretare Blerina Basha, në datën 17.03.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen me nr. 7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Ledina Mandia, z. Piro Ahmetaj dhe z. Ilia Jolldashi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Geldjon Hysolli.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga z. Sokol Pasho dhe znj. Yllka Lamçe.

Ministria e Mbrojtjes, përfaqësuar në gjykim nga znj. Yllka Lamçe.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 12, 92, 131/a, 134/1/a, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 45 dhe 49/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së

Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Mbrojtjes, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 12.6.2014, Kuvendi i Shqipërisë (më poshtë: Kuvendi) miratoi ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji nr. 59/2014).

2. Me dekretin nr. 8620, datë 4.7.2014, Presidenti i Republikës (më poshtë: Presidenti) e ktheu ligjin për rishqyrtim në Kuvend.

3. Me vendimin nr. 48/2014, Kuvendi, bazuar në Raportin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare të datës 15.7.2014, vendosi rrëzimin e dekretit të Presidentit.

4. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 114, datë 24.7.2014 dhe ka hyrë në fuqi në datë 8.8.2014.

II

5. **Kërkuesi**, Presidenti i Republikës, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) duke kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 59/2014 dhe pezullimin e zbatimit të tij. Ai ka pretenduar se ligji nr. 59/2014 ka cenuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, pasi ka shkelur dispozitat kushtetuese që përcaktojnë funksionet dhe kompetencat e Presidentit të Republikës (*Presidenti*) si Komandant i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (*FA*). Ligji nr. 59/2014 i heq Presidentit kompetenca që ai i gëzon si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, të cilat burojnë nga Kushtetuta (nenet 86, 168/2 dhe 169) e janë në përputhje me rolin e tij asnjansës dhe standardet e përcaktuara për vendet anëtare të NATO-s. Më konkretisht, sipas kërkuesit:

5.1 Nuk është marrë parapakisht mendimi i Presidentit, i cili duke qenë Komandant i Përgjithshëm i FA-ve duhej të ishte konsultuar gjatë marrjes së iniciativave ligjore që prekin kompetencat e tij në drejtimin e FA-ve.

5.2 Ligji ndërhyr në kompetencat e Kuvendit dhe Presidentit për kontrollin civil të FA-ve, sipas modelit që ekziston sot në Europë. Përqendrimi i kompetencës për ecurinë e karrierës ushtarake tërësisht te Kryeministri anashkalon kompetencat e Kuvendit. Kështu,



njësimi i gradave me funksionet organike në FA, sipas këtij ligji, përcaktohet me VKM, ndërkohë që me ligjin e mëparshëm përcaktohej me ligj të Kuvendit.

5.3 Neni 24/2/a i ligjit cenon statusin e ushtarakut, i cili mbrohet me ligj të posaçëm. Pezullimi nga detyra e ushtarakut kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën cenon parimin e sigurisë juridike dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Sipas tij, pezullimi automatik nga detyra e bën vulnerabel pozitën e ushtarakut, i cili pa pasur një dënim të formës së prerë pezullohet nga detyra duke mos i dhënë garanci për kthimin e tij në detyrë.

5.4 Ligji parashikon autoritetin përgjegjës për pezullimin nga detyra të ushtarakut duke cenuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe hierarkinë ushtarake. Neni 24/5 parashikon se pezullimi i oficerit bëhet nga Ministri i Mbrojtjes ndërsa i ushtarit nga autoriteti i emërimit. Pra, edhe oficerët me grada madhore që emërohen nga Presidenti i Republikës mund të pezullohen nga Ministri i Mbrojtjes duke mos respektuar nenin 7 të Kushtetutës si dhe duke cenuar kompetencat e Presidentit, si organ emërtese i oficerëve me grada madhore.

5.5 Ligji cenon parimin e përgjegjësisë institucionale, pasi kompetenca të Presidentit ndërthuren ose anashkalohej nga kompetenca të Kuvendit dhe Kryeministrit ose Ministrit të Mbrojtjes. Kështu, preket kompetenca e Presidentit për nxjerrjen në lirim të oficerëve me grada madhore, pasi ligji objekt shqyrtimi ia kalon këtë kompetencë Kryeministrit. Në këtë këndvështrim, Presidenti kërkon edhe një interpretim të hierarkisë së kompetencave të Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes në drejtim të FA-ve, referuar neneve 7, 12, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës.

6. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka parashtruar se:

6.1 Ligji objekt shqyrtimi është miratuar nga Kuvendi në ushtrim të funksionit të tij legjislativ të parashikuar në nenet 7, 81-85 të Kushtetutës dhe në respekt të plotë të neneve 12, 92/d, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës. Ky ligj erdhi si pasojë e mungesës së një sistemi të qartë si dhe i mospërputhjes me kërkesat e kohës dhe proceset reformuese që kanë pësuar FA-të pas anëtarësimit në NATO. Ligji ka për qëllim

përcaktimin e sistemit të menaxhimit të karrierës ushtarake në FA si dhe të kriterëve për pranimin në FA, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe karrierë, ndërprerjen e karrierës ushtarake si dhe autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e karrierës në FA.

6.2 Nuk qëndron pretendimi se nuk është marrë mendimi i Presidentit para miratimit të ligjit objekt kërkesë. Ai është ftuar nga Kuvendi me qëllim njohjen me mendimet dhe sugjerimet e tij, por Presidenti ka refuzuar të kontribuojë në këtë drejtim duke bërë të ditur se ai shprehet vetëm me anë të dekretit.

6.3 Ky ligj nuk cenon asnjë kompetencë të Kuvendit dhe as të Presidentit. Ligji përmban strukturën ligjore të nevojshme dhe garancitë e tjera lidhur me sistemin e karrierës ushtarake si dhe minimizon ndikimin e tepërt të pushteteve të tjera tek FA-të. Kompetencat që Kushtetuta i ka parashikuar shprehimisht në nenet 92/d dhe 169 të saj, Presidenti i ushtron sipas rregullimit të ligjvënësit dhe nëpërmjet ose me propozim të Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

6.4 Pezullimi i ushtarakut nga detyra kur ndaj tij fillon ndjekje penale për vepra penale që lidhen me detyrën nuk cenon statusin e ushtarakut. Kjo masë nuk njihet vetëm nga procedura penale por edhe nga ajo administrative me qëllim garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë administrative. Kufizimi në ushtrimin e detyrës së ushtarakut në këtë rast është tërësisht proporcional dhe i përligjur, pasi nëse ushtaraku do të vazhdonte të qëndronte në detyrë, atëherë një gjë e tillë do të ulte ndjeshëm besueshmërinë e publikut tek FA-të.

6.5 Në lidhje me pretendimin për paqartësi në ndarjen e kompetencave të Presidentit dhe të Kryeministrit duke favorizuar sipas kërkesit këtë të fundit sa i takon të drejtës për të pezulluar nga detyra oficerët me grada madhore, ky pretendim i kërkesit nuk qëndron, pasi sipas jurisprudencës së Gjykatës, garantimi i këtij parimi arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që sigurojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve. Kuvendi nënvizon se asnjë zgjidhje apo rregullim kushtetues nuk e parashikon Presidentin si hallkë procedurale në procesin e pezullimit të oficerëve me grada madhore.

7. **Subjektet e tjera të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Mbrojtjes**, kanë parashtruar se:



7.1 Ligji nr. 59/2014 është miratuar tërësisht në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe rregulloren e Kuvendit për procesin legjislativ. Në këtë kuptim, pretendimi se nuk është marrë mendimi i Presidentit nuk është i tillë që të mund të konsiderohet si shkelje e procedurave ligjvënëse.

7.2 Parimi i ndarjes së pushteteve mbi FA-të është rezultat i sistemit parlamentar, ndaj edhe pushteti i drejtimit qëndron jashtë FA-ve, ndërsa komandimi i tyre është vendosur nga brenda organizimit të tyre. Siç ndodh përgjithësisht në republikat parlamentare, edhe Kushtetuta e Shqipërisë ka parashikuar një kryetar shteti joqeverisës. Në bazë të Kushtetutës, Kuvendi, Presidenti dhe ekzekutivi marrin pjesë në drejtimin e FA-ve në bazë të kompetencave kushtetuese përkatëse të tyre, duke siguruar një sistem kontrollësh dhe ekuilibrash që parandalon ushtrimin e pushtetit të pakufizuar vetëm nga një degë e pushtetit. Ky ka qenë edhe vullneti i ligjvënësit, i cili nuk mund të kundërshtohet si jooportune nga kërkuesi.

7.3 Pretendimi i kërkuetit se nenet 24/2 dhe 24/5 të ligjit janë antikushtetuese, pasi parashikojnë pezullimin nga detyra të ushtarakut, kur ndaj tij fillon një procedim penal që lidhet me detyrën, është i pabazuar. Pezullimi nga detyra i një nëpunësi civil është institut i njohur i së drejtës, i cili i shërben qëndrueshmërisë së rendit juridik dhe funksionimit të shtetit të së drejtës duke synuar ruajtjen e besimit të publikut tek administrata publike. Pezullimi nuk do të thotë detyrimisht shkarkimi nga detyra, ai është vetëm një masë e përkohshme, e cila zgjat deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Nëse gjykata vendos pafajësinë e ushtarakut, ai i kthehet detyrës që mbante para pezullimit.

7.4 Lidhur me pretendimin se dalja në rezervë ose në lirim e oficerëve me grada madhore duke i kaluar Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes bie ndesh me parashikimet e Kushtetutës, të cilat ia njohin këtë kompetencë Presidentit, qëndrimi ynë është se duke qenë se Gjykata ka shfuqizuar nenin 12/ç të ligjit nr. 64/2014 që parashikonte kompetencën e Kryeministrit për të nxjerrë në lirim ose në rezervë, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me gradë madhore, atëherë edhe dispozitat respektive të ligjit objekt shqyrtimi duhen parë në këtë linjë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

8. Sipas nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Për sa i përket kërkuetit, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ai legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën sipas objektit të kërkesës.

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi

9. Kërkueti ka kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit objekt kërkesë, duke argumentuar se zbatimi i ligjit dobëson pozitën dhe cenon kompetencat e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, çka mund të sjellë pasoja të rënda për interesat shtetërorë e kombëtarë.

10. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit të paraqitur nga kërkueti dhe vlerësoi se kjo kërkesë i plotësonte pjesërisht kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 10.02.2015, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të neneve 25/3 dhe 26/4 të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë” deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.”.

C. Për pretendimin se ligji nuk është konsultuar paraprakisht me Presidentin

11. Kërkueti pretendon se ligji nuk është konsultuar paraprakisht me Presidentin, si komandant i FA-ve, duke e anashkaluar atë. Për shkak të rolit që ka Presidenti në këtë fushë dhe funksionin që i përcakton Kushtetuta dhe ligjet në fuqi, atij duhej t’i ishte marrë mendimi para miratimit të ligjit objekt shqyrtimi.

12. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashitroi se Presidentit i është kërkuar me shkresë dhënia e mendimit por ai ka refuzuar të japë mendim.



13. Gjykata vëren se kërkuesi nuk arriti të jepë argumente bindëse para Gjykatës lidhur me pretendimin se moszhvillimi si duhet i procesit të konsultimit paraprak të ligjit objekt shqyrtimi sjellë si pasojë antikushtetutshmërinë e tij. Gjykata vlerëson se, si rregull, konsultimi i një projektligji me organet që përfshihen ose preken nga fusha e rregullimit të tij është pjesë e procesit ligjvënës. Ai i shërben njohjes dhe evidentimit më të thellë të problemeve që kanë hasur këto organe gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre. Megjithatë, Gjykata çmon se procesi i konsultimit para miratimit të ligjit nuk mund të trajtohet si element, mungesa e të cilit çon detyrimisht në antikushtetutshmëri të ligjit. Për këtë arsye, Gjykata e sheh të pabazuar pretendimin për antikushtetutshmëri të ligjit mbështetur mbi këtë fakt.

Ç. Për pretendimin se nenet 25/3 dhe 26/4 e ligjit cenojnë kompetencat e Presidentit të Republikës si komandant i përgjithshëm i FA-ve

14. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi para kësaj Gjykate i përqendron pretendimet e tij në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së Presidentit, lidhur me kompetencat e tij si komandant i përgjithshëm i FA-ve. Megjithëse pretendimet e kërkuesit lidhen në tërësi me të gjithë ligjin, ai ka paraqitur edhe argumente që lidhen me dispozita të veçanta të tij duke kërkuar shfuqizimin e tyre. Për këtë arsye, Gjykata e çmon të nevojshme që para se të bëjë analizën e pretendimeve konkrete të kërkuesit, të ndalet fillimisht tek roli i Presidentit si komandant i përgjithshëm i FA-ve.

15. Neni 168/2 i Kushtetutës parashikon se Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Në këtë rol, Kushtetuta i ka dhënë Presidentit kompetenca për: drejtimin e FA-ve nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes në kohë paqeje; emërimin dhe shkarkimin e Komandantit të FA-ve, me propozim të Kryeministrit; emërimin dhe shkarkimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozim të Kryeministrit; emërimin dhe shkarkimin e komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes. Ndërsa në pikën 4 të po këtij neni është sanksionuar se *“Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura, si dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj”*. Po

ashtu, Kushtetuta, në nenin 169 të saj, ka përcaktuar në mënyrë të shprehur disa kompetenca specifike të Presidentit në lidhje me FA-të, të cilat ai i ushtron nëpërmjet ose me propozim të Kryeministrit dhe/ose Ministrit të Mbrojtjes. Nga ana tjetër, Kushtetuta, referuar pikës 4 të nenit 169, ia ka deleguar ligjvënësit caktimin e kompetencave të Presidentit, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, duke nënkuptuar se *“caktimi me ligj”* bëhet për ato kompetenca të cilat nuk parashikohen shprehimisht në Kushtetutë. Kushtetutëbërësi në rastin konkret ia ka deleguar ligjvënësit caktimin e disa kompetencave të Presidentit për ushtrimin e rolit të tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve.

16. Gjykata çmon se autoriteti drejtues i Presidentit mbi FA-të është ngushtësisht i lidhur me konceptin e kontrollit civil dhe demokratik të FA-ve. Në këtë kuptim është shprehur edhe Kushtetuta në nenin 12/2 të saj, sipas të cilit FA-të ruajnë asnjësinë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil. Presidentit i është dhënë roli i Komandantit të Përgjithshëm të FA-ve për shkak të pozitës së tij si organ jopolitik dhe përfaqësues i unitetit të popullit, në funksion të garantimit të parimeve themelore kushtetuese në sferën e mbrojtjes. Ky rol i tij është i një lloji të veçantë, pasi nuk ka karakter thjesht simbolik e, megjithatë, nuk është as një komandë e natyrës së mirëfilltë ushtarake. Në këtë kontekst, edhe pse nga pikëpamja hierarkike Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, ai nuk mund të ushtrorë autoritet komandues të llojit tekniko-ushtarak mbi FA-të, pasi në të kundërt ai do të kryente një funksion tjetër publik dhe do të duhej të mbante përgjegjësi për aktet e kryera. Kjo do të binte ndesh me nenin 89 të Kushtetutës, që parashikon se Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, dhe me nenin 90/1, sipas të cilit Presidenti nuk është përgjegjës për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij. Gjithashtu, Kushtetuta i ka atribuar Presidentit një funksion garantues në fushën e sigurisë kombëtare (neni 168/3) dhe i ka dhënë kompetenca për emërimin/shkarkimin e funksionarëve të lartë komandues të FA-ve, konkretisht: Komandantit të FA-ve, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore (neni 169 i



Kushtetutës). Emërimi/shkarkimi i këtyre funksionarëve bëhet nga Presidenti me propozim të ekzekutivit (Kryeministrit apo Ministrit të Mbrojtjes), çka nënkupton se Presidenti ushtron një lloj kontrolli mbi propozimin e ekzekutivit, që ka për qëllim të balancojë përzgjedhjen e ushtarakëve të lartë komandues të FA-ve (*vendimi nr. 10, datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar nga sa më sipër, Gjykata mori në shqyrtim pretendimin e kërkuesit se nenet 25/3 dhe 26/4 të ligjit nr. 59/2014 cenojnë kompetencat e Presidentit, sipas kërkuesit, oficerët me grada madhore që emërohen nga Presidenti mund të lirohen ose të nxirren në rezervë nga Kryeministri/Ministri i Mbrojtjes, duke anashkaluar në këtë mënyrë organin e emërtesës, pra Presidentin. Një gjë e tillë, sipas kërkuesit, cenon parimin e ndarjes së pushteteve dhe ndërhyr direkt në kompetencat e Presidentit.

18. Gjykata vëren se neni 25/3 i ligjit parashikon: *“Oficerët me gradë madhore dalin në rezervë me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.”*. Ndërsa neni 26/4 parashikon: *“Oficerët me gradë madhore dalin në lirim me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.”*. Pra, nga përmbajtja e këtyre dispozitave, rezultojnë se ato rregullojnë daljen në rezervë ose lirim të ushtarakut. Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesit për antikushtetutshmëri të neneve 25/3 dhe 26/4 të ligjit objekt shqyrtimi bazohet në të njëjtat argumente si edhe kundështimi i nenit 12/ç të ligjit nr. 64/2014, i cili u shfuqizua nga kjo Gjykatë me vendimin e saj nr. 10/2015. Neni 12, shkronja “ç”, i ligjit nr. 64/2014, i shfuqizuar tashmë, parashikonte se: *“Kryeministri nxjerr në rezervë ose lirim, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore, me përjashtim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”*. Argumentet ku u mbështet Gjykata për shfuqizimin e asaj dispozite si antikushtetuese lidheshin me pozitën dhe kompetencat e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Gjykata rithekson qëndrimin e mbajtur se Presidenti ka një rol të rëndësishëm në sistemin e karrierës ushtarake të oficerëve madhorë dhe në respektim të parimit të ndarjes e balancimit të pushteteve, si dhe parimit të asnjësisë politike të FA-ve, kushtetutbërësi ka përfshirë në procesin e karrierës ushtarake Presidentin dhe

ekzekutivin, për të shmangur kontrollin e këtij të fundit mbi këtë sistem karriere. Gjykata theksoi se është pikërisht Presidenti që gëzon kompetenca kushtetuese për emërimin dhe shkarkimin, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, të komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, si oficerë me grada madhore.

19. Gjykata rithekson se neni 169/3 i Kushtetutës i ka dhënë Presidentit kompetencën e emërimit dhe shkarkimit të komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, ndërsa neni 12/ç i ligjit i ka dhënë kompetencën Kryeministrit për nxjerrjen në rezervë/lirim të së njëjtës kategori të oficerëve madhorë. Në vlerësimin e Gjykatës kjo krijon një situatë paqartësie, e cila mund të rezultojë në keqkuptime për sa u përket autoriteteve shtetërore përgjegjëse të përfshira në procesin e karrierës ushtarake të oficerëve me grada madhore dhe kompetencat e tyre përkatëse në këtë proces. Një gjë e tillë, sipas Gjykatës, sjell pasoja negative për parimin e sigurisë juridike (*vendimi nr. 10/2015 i Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në vijim qëndrimin më të fundit të Gjykatës, rezulton se nenet 25/3 dhe 26/4 të ligjit, duke pasur një parashikim të njëjtë me nenin 12/ç të shfuqizuar nga kjo Gjykatë, cenojnë kompetencën e Presidentit për lirin apo daljen në rezervë të ushtarakëve me grada madhore, duke qenë se ai është dhe organi i emërtesës. Për këtë arsye, ato duhet të shfuqizohen si antikushtetuese.

D. Për pretendimin se nenet 24/2/a dhe 24/5 të ligjit cenojnë statusin e ushtarakut dhe kompetencën e Presidentit

21. Kërkuesi pretendon se neni 24/2/a i ligjit nr. 59/2014 që parashikon vendosjen e masës së pezullimit të ushtarakut, kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra që lidhen me detyrën, bie ndesh me statusin e ushtarakut dhe parimin e sigurisë juridike. Sipas tij, pezullimi automatik nga detyra e bën vulnerabël pozitën e ushtarakut, i cili pa pasur një dënim të formës së prerë pezullohet nga detyra duke mos i dhënë garanci për kthimin e tij në detyrë. Gjithashtu, sipas nenit 24/5 të ligjit, e drejta e pezullimit të oficerit nuk i takon Presidentit por ministrit, gjë që cenon edhe kompetencat e Presidentit, si organ emërtesë i oficerëve me grada madhore.



22. Neni 24/2/a i ligjit parashikon: “*Ushtaraku pezullohet: kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë arrest në burg ose arrest në shtëpi, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata ose kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra që lidhen me detyrën.*”. Neni 24/5 i ligjit parashikon: “*Pezullimi i oficerit nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa pezullimi i nënoficerit dhe ushtarit/detarit bëhet me urdhër të autoritetit që ka kompetencën e emërimit.*”

23. Gjkata vlerëson se vendosja e masës së pezullimit, kur ndaj ushtarakut fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën ka qenë parashikuar edhe në ligjin e mëparshëm nr. 9171/2004, i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit objekt shqyrtimi. Sipas ligjit nr. 9171/2004, ushtaraku mund të pezullohet nga detyra në rastet kur: a) *ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e arrestit me burg; b) largohet për periudhë studimi më shumë se 6 muaj.* Ligji nr. 59/2014 ka shtuar shkaqet e pezullimit nga detyra, duke parashikuar edhe raste të tjera, si: a) *kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e arrestit me burg ose arrest në shtëpi, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata ose kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën* b) *kur largohet për periudha studimi më shumë se 6 muaj; c) kur me kërkesën e tij ushtaraku largohet për të shoqëruar bashkëshortin/en që emërohet jashtë shtetit në funksione zyrtare.*

24. Gjkata konstaton se, nisur nga përmbajtja e nenit 24/2 të ligjit objekt shqyrtimi, pezullimi nga detyra si masë e përkohshme është një institut që ka qenë i përfshirë në ligjin e mëparshëm. Rasti i shtuar me ligjin e ri, pra procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën, bazohet në një arsye legjitime që ka pasur ligjëvënësi, me qëllim zhvillimin sa më korrekt të procedimit penal në ngarkim të ushtarakut. Vendosja e masës së pezullimit nga detyra për raste të tilla rrit edhe besimin e publikut tek FA. Në këtë kuptim, Gjkata çmon se kjo masë e përkohshme e kufizimit nga e drejta për të ushtruar funksionin publik deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykatat, nuk paraqet ndonjë kufizim të veprimtarisë së ushtarakut që tejkalon kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Një kufizim i tillë gjendet i parashikuar për disa funksione publike, përfshi

edhe gjyqtarët. Gjkata vlerëson se pezullimi është një masë e përkohshme, mbarimi i së cilës lidhet ose me pushimin e ndjekjes penale ndaj tij ose me dhënien e një vendimi pafajësie nga gjykata. Pas këtij momenti, ushtaraku kthehet në vendin e punës që mbante para pezullimit nga detyra, me të gjitha të drejtat që gëzonte para pezullimit. Në këtë kuptim, siguria juridike në ushtrimin e detyrës së ushtarakut është e garantuar. Për këtë arsye, Gjkata e gjen të pabazuar këtë pretendim të kërkuesit.

25. Sa i takon pretendimit për antikushtetushmëri të nenit 24/5 të ligjit që lidhet me kompetencën e organit për të vendosur pezullimin e oficerit madhor dhe të oficerëve të tjerë, Gjkata vlerëson se, duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, arrihet në përfundimin se pezullimi i oficerëve nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa pezullimi i nënoficerit dhe ushtarit bëhet me urdhër të organit të emërtesës. Pra, dispozita konkrete nuk shtrihet ndaj oficerëve me grada madhore por vetëm ndaj oficerëve të thjeshtë dhe për këtë shkak nuk ndodhemi para cenimit të kompetencës së Presidentit, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi.

26. Për sa më lart, Gjkata vlerëson se nenet 24/2/a dhe 24/5 të ligjit objekt shqyrtimi nuk bien ndesh me Kushtetutën²

DH. Për pretendimin se neni 23 i ligjit bie ndesh me nenin 118 të Kushtetutës

27. Kërkuesi pretendon se përqendrimi i kompetencës për ecurinë e karrierës ushtarake tërësisht tek Kryeministri anashkalon kompetencat e Kuvendit. Sipas tij, njësimi i gradave me funksionet organike në FA, referuar nenit 23 të ligjit objekt shqyrtimi, përcaktohet me VKM, ndërkohë që me ligjin e mëparshëm përcaktohej me ligj të Kuvendit.

28. Gjkata konstaton se neni 22 i ligjit nr. 9171/2004, i cili u shfuqizua nga ligji objekt shqyrtimi, bënte njësimin e disa gradave me disa funksione. Kështu, parashikohej që: Shefi i shtabit të përgjithshëm të FA-ve i përgjigjej gradës Gjeneral lejtant; Zëvendës shef i shtabit të përgjithshëm të FA i përgjigjej gradës Gjeneral

² Votuan edhe për shfuqizimin e nenit 24/2 të ligjit gjyqtarët G. Dizdari dhe F. Hoxha. Votuan edhe për shfuqizimin e nenit 24/5 të ligjit gjyqtarët: V. Kristo; V. Tusha; G. Dizdari.



major; Komandant i forcave tokësore i përgjigjeve gradës Gjeneral major.

29. Po ashtu, në pikën 3 të nenit 22 parashikohet se “*njësimi i gradave me funksione të tjera që nuk përfshihen në paragrafin e parë të këtij neni në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të FA, përcaktohet me vendim të KM, me propozim të Ministrisë të Mbrojtjes*.”. Pra, siç shihet ndryshimi qëndron tek fakti që me ligjin e ri të gjitha gradat dhe jo vetëm një pjesë e tyre njësohen me funksionet nëpërmjet aktit normativ të Këshillit të Ministrave. Vullneti i ligjvënësit në këtë rast ka qenë që rregullimi i çështjes së njësimit të funksioneve me gradat të bëhet me akt nënligjor dhe jo me ligj formal të Kuvendit. Vetëm ky fakt nuk e bën parashikimin ligjor antikushtetues. Gjykata thekson se përderisa parimet, organi kompetent dhe çështjet konkrete që duhen rregulluar janë parashikuar në ligjin në bazë të të cilit duhet të dalë akti nënligjor për këtë qëllim, atëherë parashikimi i ligjvënësit është në përputhje me kriteret kushtetuese që parashikon edhe neni 118 i Kushtetutës lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore, e njohur në teorinë e së drejtës kushtetuese si rezerva ligjore relative e ligjvënësit.

30. Gjykata çmon se nga pikëpamja formale ligji i plotëson këto kriteret: organi është i përcaktuar (Këshilli i Ministrave), autorizimi i tij për nxjerrjen e akteve nënligjore ekziston në ligj si dhe parimet janë të specifikuar në tërësinë e ligjit objekt shqyrtimi. Gjykata thekson se në mungesë të ndonjë detyrimi kushtetues që njësimi i gradave me funksionet duhet të bëhet patjetër me ligj formal, neni 23 i ligjit objekt shqyrtimi rezulton të jetë në përputhje me kriteret kushtetuese të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës. Për këto arsye, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit është i papabazuar.

E. Për kërkesën mbi ndarjen e kompetencave midis Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrisë të Mbrojtjes në drejtim të FA-ve, referuar neneve 7, 12, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës

31. Kërkuesi i ka kërkuar Gjykatës ndarjen e kompetencave të Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrisë të Mbrojtjes në drejtim të FA-ve duke interpretuar dispozitave kushtetuese konkrete. Sipas kërkuesit, një interpretim përfundimtar i kësaj Gjykate do t'i jepte fund paqartësive apo ndërhyrjeve të panevojshme të ligjvënësit në

kompetencat e secilit prej këtyre organeve të përfshira në drejtimin e FA-ve.

32. Gjykata ripohon qëndrimin e saj se, që të lindë një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë këto kushte të nevojshme: i) mosmarrëveshja, si rregull, të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme; ii) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve kompetente që deklarohen përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin; iii) mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese për pushtete të ndryshme, (shih vendimet nr. 26/2006, nr. 29/2006, nr. 20/2007; nr. 54/2014; nr. 36/2015 të Gjykatës Kushtetuese).

33. Gjykata, referuar edhe jurisprudencës së saj, thekson se interpretimi përfundimtar i dispozitave kushtetuese gjen zbatim vetëm në rastet kur ka një paqartësi në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese nga organet e ngarkuara me detyrën e zbatimit të tyre. Në një rast të ekzistencës së konfliktit të kompetencave, procedurë e cila ka në thelb kuptimin ose zbatimin e ndryshëm të dispozitave kushtetuese nga dy ose më shumë organe të përfshira në konflikt, kërkuesi duhet të argumentojë që paqartësia ose dykuptueshmëria ka lindur nga zbatimi i normës kushtetuese. Në këtë rast, Gjykata duke interpretuar përfundimisht normën kushtetuese përcakton edhe organin kompetent që do ta zbatojë atë.

34. Nisur nga këto standarde, por edhe duke iu referuar vendimit nr. 10/2015 të saj, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për interpretim të neneve 7, 12, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës në funksion të ndarjes së kompetencave të Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrisë të Mbrojtjes për sa i takon drejtimit të FA-ve, ka gjetur përgjigje më parë. Gjykata, në vendimin nr. 10/2015 ka vlerësuar të gjitha këto dispozita në dritën e parimeve kushtetuese duke mbajtur parasysh pretendimet konkrete të palëve pjesëmarrëse në gjykim dhe më pas duke konkluduar për secilin prej tyre. Gjykata, përderisa nuk ndodhet para një shkakut të ri për interpretim, nuk e sheh me vend të ndalet sërish në këtë çështje, e cila ka gjetur zgjidhje në vendimin e mëparshëm të saj.

35. Si përfundim, duke iu referuar analizës së



bërë më lart, Gjykata vlerëson se neni 25/3 dhe neni 26/4 i ligjit nr. 59/2014 bien ndesh me Kushtetutën dhe si të tilla duhen shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1/a, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e neneve 25/3 dhe 26/4 të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë”.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.³
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

Bashkohem me shumicën sa i takon shfuqizimit të neneve 25/3 dhe 26/4 të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë”, por ndahem sa i takon pikës së dytë të dispozitivit, rrëzimit të kërkesës për pretendimet e tjera. Konkretisht, kam qëndrimin se Gjykata duhej të kishte shfuqizuar edhe nenet 24/2 dhe 24/5 të ligjit objekt shqyrtimi për këto arsye:

Kërkuesi pretendon se neni 24/2/a i ligjit nr. 59/2014 që parashikon vendosjen e masës së pezullimit të ushtarakut, kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra që lidhen me detyrën, bie ndesh me statusin e ushtarakut dhe parimin e sigurisë juridike. Sipas tij, pezullimi automatik nga detyra e bën vulnerabël pozitën e ushtarakut, i cili pa pasur një dënim të formës së prerë

pezullohet nga detyra duke mos i dhënë garanci për kthimin e tij në detyrë. Gjithashtu, sipas nenit 24/5 të ligjit, e drejta e pezullimit të oficerit nuk i takon Presidentit por ministrit, gjë që cenon edhe kompetencat e Presidentit, si organ emërtese i oficerëve me grada madhore.

Neni 24/2/a i ligjit parashikon: “*Ushtaraku pezullohet: kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë arrest në burg ose arrest në shtëpi, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata ose kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra që lidhen me detyrën.*”. Neni 24/5 i ligjit parashikon: “*Pezullimi i oficerit nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa pezullimi i nënoficerit dhe ushtarit/detarit bëhet me urdhër të autoritetit që ka kompetencën e emërimit.*”

Shumica ka vlerësuar se vendosja e masës së pezullimit, kur ndaj ushtarakut fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën ka qenë parashikuar edhe në ligjin e mëparshëm nr. 9171/2004, i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit objekt shqyrtimi dhe se rasti i shtuar me ligjin e ri, pra procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën, bazohet në një arsye legjitime që ka patur ligjvënësi, me qëllim zhvillimin sa më korrekt të procedimit penal në ngarkim të ushtarakut. Shumica ka çmuar se kjo masë e përkohshme e kufizimit nga e drejta për të ushtruar funksionin publik deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykatat, nuk paraqet ndonjë kufizim të veprimtarisë së ushtarakut që tejkalon kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

Jam kundër këtij qëndrimi pasi në kuptim të këtij ligji masa e pezullimit për rastet kur kjo gjykohet e nevojshme për hetimin/gjykimin e ushtarakut ose një nëpunësi tjetër është e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe vendoset nga gjykata, pasi vlerëson arsyet e saj. Ndërsa në ligjin objekt shqyrtimi kjo masë jepet në mënyrë automatike, pra pa vendim të gjykatës, por vetëm duke u nisur nga fillimi i procedimit penal për vepra që lidhen me detyrën. Një gjë e tillë e vendos ushtarakun para një mundësie abuzimi dhe mosgarantimi të të drejtave të tij duke i cenuar dhe statusin e veçantë që ai ka.

Arsyeja tjetër për të cilën mendoj se duhej të ishte shfuqizuar kjo dispozitë lidhet edhe me kompetencën e organit për të vendosur pezullimin e oficerit madhor dhe të oficerëve të

³ Votuan edhe për shfuqizimin e nenit 24/2 të ligjit gjyqtarët G.Dizdari dhe F. Hoxha. Votuan edhe për shfuqizimin e nenit 24/5 të ligjit gjyqtarët: V. Kristo, V. Tusha dhe G. Dizdari.



tjerë. Shumica ka vlerësuar se, duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, arrihet në përfundimin se pezullimi i oficerëve nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa pezullimi i nënoficerit dhe ushtarit bëhet me urdhër të organit të emërtesës. Pra, dispozita konkrete, sipas shumicës, nuk shtrihet ndaj oficerëve me grada madhore por vetëm ndaj oficerëve të thjeshtë dhe për këtë shkak nuk ndodhemi para cenimit të kompetencës së Presidentit, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi.

Nuk jam dakord me këtë qëndrim të shumicës, pasi ky interpretim i saj është i sforcuar dhe nuk del nga përmbajtja e ligjit. Nëse ligjvënësi do të kishte nënkuptuar këtë qëndrim të shumicës, atëherë mund të ishte shprehur se masa e pezullimit jepet nga organet e emërtetës pa përmendur organet konkrete. Parashikimi aktual i kësaj dispozite lë vend për abuzim nga organet që nuk e kanë kompetencë pezullimin e ushtarakëve të lartë duke krijuar premisat për cenim të kompetencave të Presidentit në drejtëm të FA-ve.

Anëtar: Gani Dizdari

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë